



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

## KONTRATË PËR PUNË

*KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson z. Gëzim Ademaj, U.D. I menaxherit të Prokurimit, Rr. "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë; Dhe*

*Horn & Co. Kosova Shpk, Komuna e Deçanit, të cilën e përfaqëson z. Admir Hasanaj, me Nr. Unik Rexh. Biznesi, 810962739 perkatesisht, 810192998 (ne vazhdim "Kontraktuesit"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:*

### TITULLI I KONTRATËS:

**ZGJERIMI DHE RIPARIMI I RRUGËS NGA GRABLAT DHE LUGU I ZAJMIT**

<i>Nr. I prokurimit</i>	<i>633-20-5917 5-2-1/ C 394</i>
<i>Nr. I brendshëm</i>	<i>633 / 020 / 097 / 521</i>

### Neni 1 Lënda:

*1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:*

**ZGJERIMI DHE RIPARIMI I RRUGËS NGA GRABLAT DHE LUGU I ZAJMIT**

### Neni 2 Çmimi

*2.1 Çmimi total i punëve per aktivitetin e prokurimit ZGJERIMI DHE RIPARIMI I RRUGËS NGA GRABLAT DHE LUGU I ZAJMIT është: 15.002,00 € dhe me fjalë: /Pesëmbëdhjetë mijë zero zero zero euro €*

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

### **Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

*Marrëveshja e kontratës;*

*Kushtet e Veçanta të Kontratës;*

*Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;*

*Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;*

*Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);*

*Plani për menaxhimin e kontratës*

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

### **Neni 4 Afati i përmbushjes së kontratës:**

4.1 Kontrata do të përmbushet ne afat prej 30 ditësh, nga data e nënshkrimit të se njëjtës, perkatesisht me se larti deri me: 21.12.2020

4.2 Në qoftë se Kontrata nuk përmbushet ne afatin e paraparë, e njëjta do të ndërpritet dhe kompanija do të pergjigjet per demet eventuale te shkaktuara Autoritetit Kontraktues, sipas kushteve te përgjithshme dhe të veçanta të kontratës.

### **Neni 5 Komunikimet**

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për






pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

**Për Autoritetin Kontraktues:**  
**Komuna e Istogut**

**Për Kontraktorin:**  
**"Horn & Co Kosova" Shpk**

<b>Emri:</b>	Gëzim Ademaj	<b>Emri:</b>	 Admir Hasanaj
<b>Pozita:</b>	U.D. Menaxher-it i Prokurimit	<b>Pozita:</b>	D r e j t o r
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	04.11.2020	<b>Data:</b>	04.11.2020
<b>Vu la</b>		<b>Vu la</b>	

### PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni, Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: GJUHA SHQIPE.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <i>10% e vlerës së përgjithshme të kontratës në afat prej 30DITE ME GJATE SE PERFUNDIMI I KONTRATES.</i>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Sigurimi i vend punishtes do te jete përgjegjësi e Operatorit Ekonomik dhe te gjitha dëmtimet e punëve, dëmtimet e pronës apo humbjet e materialeve dhe pajisjeve ne vend punishte janë ne përgjegjësi te Operatorit ekonomik deri ne shumen e dëmtimeve apo humbjeve, sigurimi i vend punishtes do te jetë + 30 dite nga plani dinamik i ofruar pra nëse zgjasin punimet zgjatet edhe sigurimi i vend punishtes pra + 30 dite.
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 5 dite nga nënshkrimi i kontrates
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: 1muaj.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% për ditë por jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Ditari i Punës dhe Libri ndërtimor
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është <i>i caktuar me vendim të ZKA</i>
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: ska
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Palët do te provojnë ne mënyrë miqësore ti zgjidhin marrëveshjet ku do te organizojnë se paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kane efekt atëherë kompetente do te jetë gjykata.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë

KOMUNA E ISTOGUT					
TITULLI I AKTIVITETIT					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA-Hapja dhe zgjerimi i rruges Grabla L=1000 m					
	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia (2)	Cmimi/Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
<b>1</b>	<b>Punët përgaditore</b>				
1.1	Shenimi i trasës nga Syneja, pika e caktuar nga projektanti deri në perfundim të trasës së rrugës	m'	1,000	0.40	400.00
1.2	Prerja e shkurreve dhe drunjëve me shkulje të rrënjeve dhe bartja e materialit në deponinë e caktuar nga organi mbikqyrës (max 5 km largësi)-trasë e re	m'	1,500	0.30	450.00
	<b>Puna përgaditore</b>			<b>Subtotali</b>	<b>850.00</b>
<b>2</b>	<b>PUNIMET E DHEUT</b>				
2.1	Gërmimi i dheut të kategorisë VII dhe VIII dhe deponim të materialit në anën e kundërt (mbushje dhe trasim të rrugës), hapje e rruges	m³	1,400	1.95	2,730.00
2.2	Planifikimi i mbushjes me shtrirje dhe ngjeshje me material guror të germuar nga pjerrina	m³	900.00	1.00	900.00
2.3	Zgjerimi i kthesave të rrezikshme, planifikimi, hapja dhe mbushja me dhe natyral nga gjetjet në natyrë dhe atë në 11 vende të percaktuara nga Investitori dhe nga organi mbikqyrës. Nivelizimi dhe mbushja me dhe natyral të parashihet në trashësi prej 50-60cm. në llogari të parashihen edhe perkrahjet e nevojshme	copë	11.00	150.00	1,650.00
2.4	Planifikimi dhe thyerja e gurve me qekan automatik në pjesët gurorë dhe të pamundura për germim. Llogaria për pjesën e rrugës ku do të bëhet zgjerimi i saj-pjesa gurorë L=550m me zgjerim d=1.2m. llogaria të bhet për orë pune	orë	120.00	40.00	4,800.00
2.5	Hapja e kanaleve për largimin dhe devijimin e ujrave atmosferik, në të dy anët e rruges dhe sipas nevojë. Dimensionet e kanalit 60x60xcm	m'	960.00	0.40	392.00
	<b>Punet e dheut</b>			<b>Subtotali</b>	<b>10,472.00</b>
<b>3</b>	<b>MBISTRUKTURA</b>				
3.1	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer natyral i gjetur në natyrë dhe me trashësi mesatare prej d=30-40cm	m²	1,200.00	1.40	1,680.00
	<b>Mbistruktura</b>			<b>Subtotali</b>	<b>1,680.00</b>
<b>4</b>	<b>PUNËT E BETONIT</b>				
4.1	Furnizimi, transporti dhe vuarja në veper e gypave nga betoni të profilit Ø800 për kalesat e pegjatë rruges dhe depertimin e ujrave atmosferike	m'	80.00	25.00	2,000.00
	<b>Punet e betonit</b>			<b>Subtotali</b>	<b>2,000.00</b>

Rekapitullimi					
	<b>Punet përgaditore</b>				<b>850.00 €</b>
	<b>Punimet e dheut</b>				<b>10,472.00 €</b>
	<b>Mbistruktura</b>				<b>1,680.00 €</b>
	<b>Punimet e betonit</b>				<b>2,000.00 €</b>
	<b>TOTALI ME TË GJITHA NGARKESAT</b>				<b>15,002.00 €</b>

